

Këshillimi Fetar

NË PROGRAMET E DERADIKALIZIMIT

Raport mbi vlerësimin e nevojave

Hartëzim i nevojave dhe metodës së zbatimit të këshillimit fetar si një masë për riintegrimin, rehabilitimin dhe risocializimin e individëve të dënuar për krime të ekstremizmit të dhunshëm në Maqedoni

GCERF
Preventing Violent Extremism
HORIZON
CIVITAS
MIMC

Shoqata për aktivizëm qytetar dhe nxitje të përgjegjësisë shoqërore **HORIZON CIVITAS**
Shkup, Maqedoni

Raport mbi vlerësimin e nevojave

për këshillim fetar në programet e deradikalizimit

March, 2024

Titulli: Raport mbi vlerësimin e nevojave për këshillim fetar në programet e deradikalizimit

Botues: Shoqata për aktivizëm qytetar dhe nxitje të përgjegjësisë shoqërore
HORIZON CIVITAS

Autorë: Amir Kadri dhe Samet Shabani

Dizajni grafik: A2 Digital World

Përkthim nga anglishtja në shqip: Fjolla Zllatku Ajrullahu

Formati: elektronik dhe i shtypur

Qarkullimi i printuar: ~20 palë të interesit

Qasja: e hapur për publikun

Raporti është përgatitur si pjesë e projektit "Rruga drejt rezistencës dhe riintegrimit të familjeve të cenueshme në komunitet", zbatuar nga Konsorciumi i organizatave, Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar - MCMS, Horizon Civitas, Iniciativa për Perspektivë Evropiane - IEP, Koncepti Qytetar Nexus dhe Organizata Pleiades. Projekti mbështetet nga Fondi Global për Angazhimin dhe Qëndrueshmërinë e Komunitetit (GCERF).

Ky raport është përgatitur me mbështetjen financiare të GCERF. Mendimet dhe përmbajtja janë përgjegjësi e vetme e autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e GCERF dhe pikëpamjet e organizatave të tjera që e zbatojnë atë.

Raport mbi vlerësimin e nevojave

për kështillim fetar në programet e deradikalizimit

PËRMBAJTJA

01. Akronime dhe shkurtesa 1

02. Listë e shtojcave

03. Përmbledhje ekzekutive 3

Gjetje nga vlerësimi i nevojave 5
Qasje e përgjithshme ndaj këshillimit fetar
Zbatueshmëria ose korniza institucionale
Përmbajtja dhe zbatimi
Rekomandime për vlerësimin e nevojave 7

04. Hyrja dhe prapavija 8

Konteksti

05. Metodologjia 10

Rishikim i dokumentacionit
Identifikim i palëve të interesuara
Intervista të thella me palët e interesuara
Grupi i fokusit 11
Analizë e të dhënave
Diskutim i palëve të interesuara në tryezë të rrumbullakët
Kufizime të vlerësimit të nevojave

06. Rezultatet dhe gjetjet 14

Qasjet e përgjithshme ndaj këshillimit fetar
Zbatueshmëria ose korniza individuale
Përmbajtja dhe zbatimi: 17
Këshillim për deradikalizim

07. Praktika të mira 21

08. Përfundime dhe rekomandime 23

09. Shtojca 27

Shtojca A: Identifikimi i palëve të interesuara në vlerësimin e nevojave
Shtojca B: Referenca dhe listë e dokumenteve të shqyrtuara 28
Shtojca C: Udhëzues për intervista 30
Shtojca D: Prezantim i diskutimit në tryezë të rrumbullakët 34

Akronime dhe Shkurtesa

Akronime	Përshkrimi
KE	Këshilli i Evropës
KMBFGR	Komisioni për Marrëdhënie me Bashkësitë Fetare dhe Grupet Religjioze në Maqedoni
OSHC	Organizatat e shoqërisë civile
QPS	Qendra për punë sociale
PVE	Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm
DES	Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve
BE	Bashkimi Evropian
FSHI	Fakulteti i Shkencave Islame
FTO	Fakulteti i Teologjisë Ortodokse
GCERF	Fondi Global për Angazhimin dhe Qëndrueshmërinë e Komunitetit
KNPEDHLT	Komiteti Nacional për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftimin e Terrorizmit
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
BFI	Bashkësia Fetare Islame
ELMRRR	Ekipet lokale multidisiplinare për riintegrim, rehabilitim dhe risocializim
KMO-AO	Kisha Ortodokse Maqedonase - Kryepeshkopata e Ohrit
MiM	Memorandumi i Mirëkuptimit
RNR	Rrjeti i Ndërgjegjësimit për Radikalizimin
RRR	Rehabilitimi, risocializimi dhe riintegrimi
PSP	Protokolli standard i operimit
VEP	Shkelës i dhunshëm ekstremist

Lista e shtojcave

	Lista e shtojcave	Faqe
Shtojca A	Identifikimi i palëve të interesuara për vlerësimin e nevojave	27
Shtojca B	Lista e dokumenteve për shqyrtim	28
Shtojca C	Udhëzues për intervistë	30
Shtojca D	Prezantim i diskutimit në tryezë të rrumbullakët	34

Përmbledhje ekzekutive

Në dhjetor 2023, Horizon Civitas porositi një vlerësim tetëmbëdhjetëmujor të nevojave për këshillim fetar Maqedoni, si një mjet për riintegrimin, rehabilitimin dhe risocializimin e personave të kthyer nga zonat e konfliktit në Siri dhe Irak.

Qëllimi i vlerësimit të nevojave ishte koleksionimi dhe përmbledhja e pikëpamjeve të palëve të interesuara rreth mekanizmave dhe burimeve aktuale të disponueshme për përshtatjen e këshillimit fetar si një mjet të dobishëm në riintegrimin e të kthyerve. Vlerësimi kishte për qëllim të identifikonte pikëpamjet e palëve të interesuara mbi mangësitë kryesore në identifikimin, referimin, ndihmën dhe mbështetjen fetare për grupin e synuar. Gjithashtu, palët e interesuara u pyetën për rekomandime se si mund të krijohet një sistem funksional i këshillimit gjatë dhe/ose pas vuajtjes së dënimit me burg nga ana e shkelësve të dhunshëm ekstremistë (VEP). Si i tillë, ky vlerësim i nevojave është një burim i besueshëm në formën e një'analize të mundësive për përfshirjen e komuniteteve fetare në procesin e rehabilitimit dhe riintegrimit të të dënuarve', si masë për të arritur qëllimin strategjik 4.1 Përjashtimi/ Deradikalizimi në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm 2023-2027 të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Ekziston një shqetësim gjithnjë e më i madh lidhur me potencialin për radikalizim dhe aktivitete terroriste nga ana e VEP në Maqedoni (në burg ose në periudhën pas lirimit). Çështja e radikalizimit në burgje është identifikuar në disa raporte. Raporti i BE-së i vitit 2022 për vendin rekomandon vazhdimin e zbatimit të Planit të përbashkët të veprimit kundër terrorizmit me fokus deradikalizimin në burgje. Rrjedhimisht, rritja e kapaciteteve institucionale për të parandaluar radikalizimin në burgje është në krye të axhendës së përpjekjeve të vendit për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm. Në këtë drejtim, Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve (DES) ka filluar të punojë ngushtë me Këshillin e Evropës (KE) në vitet e fundit.

Ndërsa qasjet aktuale për deradikalizimin dhe/ose riintegrimin në vend përfshijnë në rend të parë psikologë, pedagogë dhe punonjës socialë, shërbimet këshilluese nga ana e personave fetarë mbeten një temë e paprekur. Pa referim dhe mbështetje të duhur për të gjithë personat që kanë qenë viktima të iluzionit fetar si një motiv shtytës për t'u bashkuar me grupet terroriste, është e pamundur të kemi e një përgjigje gjithëpërfshirëse ndaj radikalizimit. Ky raport i vlerësimit të nevojave flet për zbatueshmërinë e përfshirjes potenciale të punëtorëve fetarë në këto përpjekje dhe shërben si udhërrëfyes në krijimin e politikave përkatëse. Si i tillë, raporti përqendrohet në identifikimin e kapaciteteve aktuale institucionale për të prodhuar rekomandime në mënyrë adekuate.

Vlerësimi i nevojave kishte pesë hapa kryesorë: (1) rishikimi dokumentacionit që nënkupton mbledhjen, kodimin dhe analizën e dokumenteve të identifikuara nga Horizon Civitas dhe të plotësuara nga ekipi hulumtues; (2) krijimi i një mjeti për identifikimin e palëve të interesuara për t'u angazhuar në vlerësimin e nevojave; (3) intervista ballë për ballë dhe online me palët e identifikuara; (4) fokus grup me palët e identifikuara; (5) një analizë përmes trekëndëshimit të të dhënave nga të gjitha burimet, duke përdorur një skemë të strukturuar kodimi për nxjerrjen e gjetjeve dhe formulimin e rekomandimeve fillestare; (6) prezantimi dhe korrigjimi/validimi i gjetjeve dhe rekomandimeve të studimit në tryezë të rrumbullakët me palët e interesuara.

Ndonëse vlerësimi i nevojave ofroi të dhëna të rëndësishme, ai kishte disa kufizime që duhen përmendur:

Fokusimi në pikëpamje subjektive:

- Studimi u mbështet kryesisht në pikëpamjet e palëve të interesuara, që do të thotë se të dhënat pasqyrojnë njohuritë dhe mendimet e tyre personale në lidhje me këshillimin fetar, mungesën e burimeve dhe zgjidhjet e mundshme. Ky kontribut i vlefshëm, megjithatë, kufizon objektivitetin e një fotografie të përgjithshme.

Sfida e përgjithësimit:

- Për intervistat u përdorën mostra sipas konveniencës, duke kufizuar kështu zbatueshmërinë e gjetjeve në popullata më të gjera. Pikëpamjet e përfaqësuesve të zgjedhur nga qeveria, agjencitë ose grupet e tjera mund të mos përfaqësojnë në mënyrë gjithëpërfshirëse pikëpamjet e të gjithë individëve në këto institucione.

Peizazh i pabarabartë i të dhënave:

Rishikimi i dokumentacionit dhe intervistimi dallon nga vendi në vend për shkak të niveleve të ndryshme të disponueshmërisë, çka potencialisht krijon një çekuilibër të të dhënave.

Struktura e paparashikueshme e rekomandimeve:

- Plani ynë fillestar ishte kategorizimi i rekomandimeve të palëve të interesuara në: aktivitete të menjëhershme, qëllime të përkohshme dhe aspirata afatgjata. Megjithatë, më shumë se 90% e palëve të interesuara nuk arritën të bënin këtë diferencim, duke çuar në rekomandime të pakategorizuara, gjë e cila potencialisht paraqet një sfidë sa i përket prioritizimit.

Pavarësisht këtyre kufizimeve, qasja e metodës së përzier, duke bashkuar të dhënat cilësore dhe sasiore përmes gjetjeve triangulare në mënyrë efektive gjeneron njohuri të rëndësishme mbi burimet, boshllëqet dhe nevojat për këshillim fetar në të gjithë vendin. Megjithatë, gjatë interpretimit dhe zbatimit të këtyre gjetjeve, duhen marrë parasysh kufizimet e lartpërmendura.

Gjetje nga vlerësimi i nevojave

Vlerësimi i nevojave rezultoi në 12 gjetje kryesore, të cilat nuk mbulojnë domosdoshmërisht çdo pyetje ose temë të parashtuar. Problemet i kemi renditur në bazë të prioritetit, si më poshtë:

- Të përmendura shpesh: Të cituara vazhdimisht nga ana e informuesve, të anketuarve dhe në dokumente.

- Të diskutuara gjerësisht: Probleme të cilave u është kushtuar një kohë dhe hapësirë më e madhe në intervista, përgjigje dhe raporte.

- Të zbatueshme gjerësisht: Vazhdimisht të identifikuara në lloje të ndryshme të të anketuarve dhe raporteve.

Këto gjetje i kemi ndarë në tri kategori:

- **Qasje të përgjithshme:** Qasje të përgjithshme ndaj këshillimit fetar në Maqedoni

- **Korniza institucionale:** Strukturat dhe sistemet zbatuese për zbatimin e këshillimit fetar.

- **Përmbajtja dhe zbatimi:** Temat dhe metodat konkrete për realizimin efektiv.

Në këtë drejtim, gjetjet e këtij raporti janë grupuar dhe ndarë si më poshtë:

Qasje të përgjithshme ndaj këshillimit fetar

- Këshillimi fetar kryesisht shihet si një koncept teologjik (udhëzim shpirtëror), jo si praktikë apo masë e P/CVE. Kjo gjë paraqet një kompleksitet në kuptimin e rolit të imamëve në këtë proces, ku ata inkuadrohen më shumë si "mbështetës" sesa si trajtues të drejtpërdrejtë të rasteve.

- Qëndrimi i përgjithshëm ndaj këshillimit fetar është se ai është i dobishëm për të dënuarit. Përveç kësaj, shumica besojnë se ai do të mirëpritet nga popullata e burgjeve.

- Mungesa e punonjësve fetarë zyrtarisht të deleguar (të emëruar në bashkëpunim me Bashkësinë Fetare Islame) për të kryer lutjen islame (falja) të së premtes në burgje, lë hapësirë që VEP të abuzojë me lutjen për radikalizim të mëtejshëm në burgje.

Zbatueshmëria ose korniza institucionale

- Qasja e Komisionit për Marrëdhënie me Bashkësitë Fetare dhe Grupet Religjioze (KMBFGR), ndaj kësaj lloj mase, në koordinim me Komitetin Nacional për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftimin e Terrorizmit (KNPEDHLT), si dhe komunitetet fetare, është diçka thelbësore.

- Sistemi më i mirë i angazhimit të punonjësve fetarë për këshillim është përmes emërimeve nga ana e komuniteteve fetare me të cilat pastaj DES do të lidhë marrëveshje individuale si "konsulentë të përkohshëm".

- Ndërkohë që burimet njerëzore aktuale për zbatimin e një mase të tillë në institucionet përkatëse janë relativisht të mjaftueshme, kjo nuk ndodh me burimet operacionale dhe financiare.

Përmbajtja dhe zbatimi:

- Ndërsa këshillimi fetar për popullatën e përgjithshme të burgjeve është identifikuar si një mjet i dobishëm në bazë vullnetare, ai propozohet si masë e detyrueshme për VEP.

- Ekziston një ndryshim i rëndësishëm midis temave të sugjeruara gjatë këshillimit fetar për popullatën e përgjithshme të burgjeve dhe atyre për VEP.

- Përveç kësaj, ka një ndryshim të rëndësishëm në shpeshtësinë e zbatimit të kësmase midis popullatës së përgjithshme të burgjeve dhe VEP.

Rekomandime për vlerësim të nevojave

Përmes rekomandimet që dolën nga pikëpamjet e palëve të interesuara dhe nga këto gjetje, qëllimi është të kapërcehen mangësitë kryesore për zbatimin e mundshëm të këshillimit fetar si një masë brenda fushëveprimit të politikave të RRR. Rekomandimet kryesore pasqyrojnë sugjerimet e bëra nga informuesit e intervistuar dhe të anketuarit e hulumtimit, dhe janë diskutuar dhe konfirmuar në Tryezën e rrumbullakët për rolin e komuniteteve fetare në masat për parandalim të ekstremizmit të dhunshëm që çon në terrorizëm. Ekzistojnë 10 rekomandime të renditura sipas temës. Renditja e tyre nuk është bërë sipas rëndësisë. Secila nga rekomandimet është renditur në Seksionin 5. VI. Përfundim dhe rekomandime

Për institucionet:

Rekomandimi 1: Të formojnë një Grup Pune për Këshillim Fetar për RRP e VEP

Rekomandimi 2: T'i identifikojnë burimet operacionale dhe financiare

Rekomandimi 3: Të vendosin Procedurë Standarde të Operimit (PSO) për këshillim fetar

Rekomandimi 4: T'i angazhojnë dhe certifikojnë punëtorët e emëruar fetarë

Rekomandimi 5: T'i forcojnë kapacitetet e punëtorit të angazhuar fetar

Rekomandimi 6: Të përgatisin një listë të temave për këshillim fetar

Rekomandimi 7: Të zbatojnë politika monitorimi dhe vlerësimi

Për Bashkësinë Fetare Islame:

Rekomandimi 1: Të përgatisë një listë të punëtorëve të emëruar fetarë

Rekomandimi 2: Të caktojnë një person përgjegjës për këshillim fetar

Për shoqërinë civile:

Rekomandimi 1: Të zbatojnë aktivitete për ngritjen e kapaciteteve për këshillim fetar

Hyrja dhe prapavija

Në dhjetor 2023, Horizon Civitas porositi një vlerësim tetëmbëdhjetëmujor të nevojave për këshillimin fetar në Maqedoni, si një mjet për riintegrimin, rehabilitimin dhe risocializimin e personave të kthyer nga zonat e konfliktit në Siri dhe Irak.

Qëllimi i vlerësimit të nevojave ishte hartëzimi i situatës aktuale, sfidave dhe rekomandimeve për zbatimin e kësaj mase në Maqedoni. Vlerësimi synonte të vinte në dukje boshllëqet kryesore që lidhen me zbatimin e masës në vend, duke krijuar njëkohësisht një bazë për zbatimin e mundshëm në të ardhmen e afërt. Prandaj, raporti është një burim i besueshëm për institucionet që duan të analizojnë përfshirjen e komuniteteve fetare në rehabilitimin dhe riintegrimin e të dënuarve, si masë për arritjen e objektivit specifik 4.2 Përjashtimi/ Deradikalizimi të Strategjisë Kombëtare për PEDH 2023-2027 të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Kjo pjesë e raportit ofron një pasqyrë të shkurtër të këshillimit fetar si një masë për RRR, si dhe situatën aktuale në Maqedoni për zbatimin e një mase të tillë. Seksioni 2 përshkruan metodologjinë e përdorur në vlerësim, paraqet kornizën dhe pyetjet kryesore kërkimore për vlerësimin, si dhe thekson kufizimet e hulumtimit. Seksioni 3 përshkruan gjetjet kryesore të vlerësimit. Gjetjet i kemi organizuar bazuar në pyetjet kërkimore të vlerësimit, duke përfshirë: (1) qasjet e përgjithshme ndaj këshillimit fetar, (2) zbatueshmërinë ose kornizën institucionale, dhe (3) përmbajtjen dhe zbatimin. Çdo temë kërkimore shfaqet me shkronja të trasha. Secila prej tyre ndiqet nga gjetjet në lidhje me pyetjen, të vendosura me një pikë dhe shkronja të pjerrëta për të dalluar statusin e tyre si gjetje. Çdo artikull pasohet nga një diskutim i të dhënave mbështetëse, duke përfshirë citime ilustruese të mbledhura gjatë intervistave. Seksioni 4 ofron një pasqyrë të praktikave të mira të këshillimit fetar si një masë për RRR nga rajoni dhe më gjerë. Raporti përfundon me Seksionin 5, i cili ofron një sërë rekomandimesh të palëve të interesuara me konkluzione të përmbledhura. Ky raport përfshin edhe shtojcat e mëposhtme: Shtojca A: Identifikimi i palëve të interesuara për vlerësimin e nevojave, Shtojca B: Listë e dokumenteve për shqyrtim, Shtojca C: Udhëzues për intervista, Shtojca D: Prezantimi i diskutimit në tryezë të rrumbullakët.

Konteksti

Me kthimin e personave pjesëmarrës në luftërat në Siri dhe Irak, pushtetet maqedonase i dhanë prioritet agjendës për riintegrim, risocializim dhe rehabilitim. Në këtë kontekst, qeveria, nëpërmjet Komitetit Kombëtar për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftë Kundër Terrorizmit, ka themeluar një grup ndërinstitucional pune që fokusohet në riintegrimin, risocializimin dhe rehabilitimin e luftëtarëve të huaj të kthyer dhe anëtarëve të familjes së tyre. Si pasojë, Grupi ka përgatitur një Plan Kombëtar për Riintegrimin, Risocializimin dhe Rehabilitimin (RRR), ka krijuar ekipe lokale multidisiplinare për RRR

(ELMRRR) në disa komuna dhe ka hartuar Protokollin Standard Operacional (PSO). Megjithëse Plani Kombëtar ka marrë vlerësime të larta nga disa ekspertë ndërkombëtarë, disa ekspertë vendas sugjerojnë se procesi i përgatitjes nuk ka pasur inkluzivitet, veçanërisht pasi nuk përfshin thelbësisht palë të rëndësishme të interesuara si shoqëria civile apo bashkësitë fetare.

Studime të shumta mbi shfaqjen, manifestimin dhe prirjet e ekstremizmit të dhunshëm në vend theksojnë se keqkuptimet ideologjike dhe keqinterpretimet e fesë kanë një rol kyç në procesin e radikalizimit dhe rekrutimit të individëve për konfliktet e huaja në Siri dhe Irak.[1][2][3] Përveç kësaj, vëzhgimet në terren sugjerojnë se shkelësit e dhunshëm ekstremistë (VEP) kontribuojnë aktivisht në radikalizimin e mëtejshëm të të dënuarve të tjerë nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme. Megjithatë, as Plani Kombëtar për RRR për luftëtarët e huaj terroristë të kthyer nga Siria dhe Iraku dhe anëtarët e familjes së tyre, as Plani i Veprimit për LEDH 2023-2027 nuk parashikojnë një masë të drejtpërdrejtë që mund të zgjidhë përfundimisht çështjen. Duke pasur parasysh madhësinë dhe kompleksitetin e çështjes, është vendimtare të zbatohen masa që do të inkurajojnë riorientimin e besimeve dhe qasjeve të tyre fetare.

Duke neglizhuar problemin, qeveria rrezikon: (1) të anashkalojë masat kyç dhe mos të arrijë t'i japë përparësi parandalimit të radikalizimit të mëtejshëm midis të burgosurve aktualë dhe të ardhshëm, (2) të keqkuptojë kërcënimin: duke mbetur prapa sa u përket zhvillimit të përgjigjeve të nuancuara ndaj natyrës së ndryshueshme të radikalizimit në burgje dhe (3) të humbasë partnerë kyç: mosbashkëpunimi me shoqërinë civile dhe bashkësitë fetare, duke penguar programet deradikalizuese të bazuara në prova, brenda dhe jashtë burgjeve. Nga ana tjetër, rezultatet e vendeve të rajonit dhe më gjerë, që i angazhojnë punonjësit fetarë në procesin e deradikalizimit në burgje dhe periudhën pas burgut, tregojnë ndikimin e jashtëzakonshëm të këshillimit fetar. Kjo ndërhyrje rezulton efektive në reduktimin e motivimit për dhunë midis shkelësve të dhunshëm ekstremistë (VEP) dhe në transformimin e botëkuptimeve dhe qasjeve të tyre radikale. Nisur nga konteksti lokal, shtete të caktuara kanë krijuar modele të suksesshme bashkëpunimi mes institucioneve shtetërore, komuniteteve fetare dhe organizatave qytetare. Këto modele përdorin ekspertizën e këshillimit fetar për të deradikalizuar individët në fjalë.

1 Kadri, A. and Shabani, S. (2018). "Working towards resilient communities". Analytica Think Tank."
2 Feta, B., Armakolas I. & Krstinovska A. (2023). "Community resilience against violent extremism in North Macedonia", ELIAMEP.
3 Vançoski, A., Shikova, H. & Мусли, A. (2020) "Përmirësimi i kuptimit të fenomenit të luftëtarëve të huaj terrorist (LHT): Sfidat e rehabilitimit, risocializimit dhe riintegrimit të të kthyerve dhe ndihmësve në Republikën e Maqedonisë së Veriut", Nexus Civil Concept

Duke pasur parasysh këtë, Horizon Civitas vendosi të kryejë një vlerësim të burimeve dhe nevojave aktuale. Qëllimi është të identifikohen mekanizmat më efektivë për zbatimin e mundshëm të kështillimit fetar si një masë në procesin e riintegrimit, risocializimit dhe rehabilitimit në vend. Për të drejtuar studimin, Horizon Civitas përpiloi një ekip të vogël hulumtues, i cili hartoi një kornizë të vlerësimit të nevojave, duke përfshirë aktivitete për mbledhje dhe analizë të të dhënave. Korpusi i kornizës përfshin një sërë çështjesh hulumtuese bazuar në qëllimin që ka vetë studimi. Ekipi i organizoi masat në instrumente adekuate për mbledhjen dhe analizën e të dhënave, duke përfshirë një strukturë analitike kodimi për shqyrtimin e dokumentacionit (dhe si vijim një analizë cilësore të të dhënave), një pyetësor të shtypur për intervistat ballë për ballë, një version në ueb të të njëjtit pyetësor kur intervistat ballë për ballë nuk janë praktike dhe një prezantim në PowerPoint për t'ua lehtësuar diskutimin palëve të interesuara në tryezën e rrumbullakët.

Metodologjia

Në këtë seksion, ne japim një përshkrim të metodologjisë së përdorur në vlerësim, paraqesim kornizën dhe pyetjet kryesore kërkimore për vlerësim, si dhe theksojmë kufizimet e hulumtimit. Vlerësimi i nevojave përbëhej nga gjashtë hapa kryesorë: (1) shqyrtimi i dokumentacionit që konsiston në mbledhjen, kodimin dhe analizën e dokumenteve të identifikaura nga Horizon Civitas dhe të plotësuara nga ekipi hulumtues; (2) zhvillimi i një mjeti për identifikimin e palëve të interesuara që ato të përfshihen në vlerësimin e nevojave; (3) intervista me palët e interesuara që janë identifikuar -ballë për ballë dhe online; (4) një grup fokusi me palët e interesuara që janë identifikuar; (5) analizë dhe trekëndëshim i të gjitha burimeve të të dhënave duke përdorur një skemë të strukturuar kodimi për zhvillimin e gjetjeve dhe rekomendimeve fillestare; (6) prezantimi dhe korrigjimi/validimi i gjetjeve të studimit dhe rekomandimeve të punëtorisë me palët e interesuara.

Rishikimi dokumentacionit

Shqyrtimi i dokumentacionit përfshin dokumente institucionale dhe hulumtime mbi kështillimin fetar dhe deradikalizimin në Maqedoni. Ekipi hulumtues identifikoi një sërë dokumentesh dhe raportesh që duhen konsideruar për t'u përfshirë në shqyrtimin e dokumentacionit. Janë identifikuar gjithsej 12. Nga këto, ekipi ka shqyrtuar, plotësuar dhe përfundimisht ka përfshirë 8 dokumente kyç studimi (Shtojca B: Lista e dokumenteve për shqyrtim). Dokumentet kanë ofruar një kontekst bazë për elaborimin e mëtejshëm të temës.

Identifikimi i palëve të interesuara

Ekipi hulumtues ka zhvilluar një Mjet kornizë për identifikimin e palëve të interesuara për vlerësimin e nevojave (Shtojca A: Identifikimi i palëve të interesuara në vlerësimin e nevojave) për të mbështetur Horizon Civitas në identifikimin dhe angazhimin e palëve të interesuara në vlerësimin e nevojave. Mjeti kishte për qëllim të ndihmonte Horizon Civitas për të identifikuar një grup gjithpërfshirës dhe të rëndësishëm palësh të interesuara të cilat do të angazhohen në vlerësimin e nevojave. Duke pasur parasysh rëndësinë e tyre kontekstuale në këtë temë, palët e interesuara u kategorizuan në bazë të objektivit të tyre kryesor, përkatësisë dhe burimeve të financimit.

Intervista të thella me palët e interesuara

Komponent thelbësor i vlerësimit të nevojave ishin pikëpamjet dhe perspektivat e palëve të interesuara, veçanërisht të donatorëve të përfshirë në programet e deradikalizimit në Ballkanin Perëndimor. Për të fituar njohuri të hollësishme dhe të nuancuara mbi situatën dhe nevojat aktuale, ekipi hulumtues zhvilloi intervista të drejtpërdrejta dhe online me një numër të madh të palëve kryesore të interesuara. Lista e informuesve dhe të anketuarve është bërë nga Horizon Civitas. Në përputhje me pyetjet kërkimore, ekipi hulumtues ka formuluar një sërë pyetjesh për të shërbyer si bazë për krijimin e një udhëzuesi intervistash gjysmë të strukturuar. Në total, janë kryer 24 intervista me palë të identifikuara. Nga këto, 17 janë realizuar ballë për ballë dhe 7 online.

Grupi i fokusit

Duke pasur parasysh rëndësinë direkte të temës së këshillimit fetar si një masë deradikalizimi, u zhvillua një sesion i grupit të fokusit me Drejtorinë për Ekzekutimin e Sanksioneve. Grupi përbëhej nga pesë punonjës të Drejtorisë, të cilët vijnë nga sektorët e riintegrimit, risocializimit dhe rehabilitimit të VEP. Për grupin e fokusit u përdor udhëzues i gjysmëstrukturuar intervistash.

Analizë e të dhënave

Ekipi kërkimor së pari analizoi të dhënat cilësore të hulumtimit (dokumente dhe intervista) duke zhvilluar kode specifike për temën bazuar në pyetjet kërkimore. Kodimi ndihmoi ekipin të përcaktonte temat më të shpeshta, skemat dhe përgjigjet më të zakonshme dhe të zhvillonte një sërë gjetjesh konkrete në përputhje me këtë. Së fundi, ky proces i mundësoi ekipit të grumbullonte gjetjet për të hartuar një sërë rekomandimesh se si zbatohet sa më mirë këshillimi fetar në praktikë.

Diskutimi i palëve të interesuara në tryezë të rrumbullakët

Në përfundim të këtij vlerësimi konciz të nevojave u thërritën palët kryesore të interesuara për të diskutuar dhe rafinuar gjetjet dhe rekomandimet nga studimi. Horizon Civitas identifikoi një grup palësh të interesuara në vend dhe i ftoi ato në një tryezë të rrumbullakët për të diskutuar përfshirjen e komuniteteve fetare në mekanizmat parandalues për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm që çon në terrorizëm. Diskutimi i tryezës së rrumbullakët konsistonte në: (1) paraqitjen e gjetjeve dhe rekomandimeve paraprake nga hulumtimi dhe (2) diskutimin e gjetjeve dhe rekomandimeve. Qëllimi ishte të përgatitej një përmbledhje përfundimtare rekomandimesh që pasqyrojnë prioritetet e palëve të interesuara për hapat e ardhshëm drejt zhvillimit të një moduli për përfshirjen e komuniteteve fetare në procesin e RRR duke ofruar këshillim fetar.

Kufizime të vlerësimit të nevojave

Ky vlerësim i nevojave, megjithëse informues, u përball me disa kufizime, disa të identifikuara më herët. Është e rëndësishme që këto kufizime të merren parasysh gjatë interpretimit të gjetjeve:

Mbështetje e të dhënave:

- Bazuar në palët e interesuara: Hulumtimi është mbështetur shumë në perceptimet dhe pikëpamjet e palëve të interesuara, gjë që ka çuar drejt njohurive subjektive sa i përket këshillimit fetar. Edhe pse kontributi i tyre ishte i vlefshëm, ai nuk paraqet një analizë objektive të të gjithë peizazhit.

- Rishikim i kufizuar i literaturës: Megjithëse u shqyrtua mundësia i një hulumtimi të jashtëm, ky nuk ishte një rishikim gjithëpërfshirës, si pasojë potencialisht mund të mungojnë perspektivat më të gjera.

Marrja e mostrave dhe përgjithësimi:

- Marrja e mostrave sipas konveniencës: Pjesëmarrësit në intervistë ishin individë lehtësisht të arritshëm, jo të zgjedhur rastësisht. Kjo kufizon zbatueshmërinë e gjetjeve për popullata më të mëdha.

- Disponueshmëri e ndryshme e të dhënave: Si rishikimi i dokumentacionit, ashtu edhe informuesit e intervistës ndryshonin për sa i përket qasjes në të gjithë rajonin, gjë që potencialisht mund të shtrembëronte të dhënat.

Struktura e rekomandimeve:

- Rekomandime të pakategorizuara: Palët e interesuara kryesisht janë përmbajtur nga kategorizimi i rekomandimeve në qëllime të menjëhershme, të përkohshme dhe afatgjata. Kjo e bën të vështirë përcaktimin e veprimeve të ardhshme në bazë të prioritetit.

Gatishmëria e palëve të interesuara për pjesëmarrje:

Diskutimi në tryezë të rrumbullakët: Diskutimi në tryezë të rrumbullakët të palëve të interesuara, megjithëse i vlefshëm sa u përket informacioneve kthyese, nuk garanton pranimin universal të gjetjeve dhe rekomandimeve. Pikëpamjet individuale mund të ndryshojnë.

Paragjykimet e mundshme:

- Njëanshmëria gjatë vetëzgjedhjes: Pjesëmarrësit që janë vetëzgjedhur për të marrë pjesë vullnetarisht mund të kenë pikëpamje më të forta lidhur me temën në krahasim me të tjerët, duke ndikuar kështu te të dhënat.

- Njëanshmëria me qëllim të përshtatjes shoqërore: Të anketuarit mund të përgjigjen në mënyra që ata i konsiderojnë shoqërisht të pranueshme, duke shtrembëruar informacionin e vetëraportuar.

Pavarësisht këtyre kufizimeve, studimi ka kombinuar në mënyrë efektive trekëndëshimin cilësor dhe sasior të të dhënave për të gjeneruar njohuri të vlefshme për burimet, mungesat dhe nevojat për këshillim fetar. Megjithatë, janë kufizime që duhen marrë parasysh gjatë interpretimit dhe zbatimit të gjetjeve.

Rezultatet dhe gjetjet e vlerësimit të nevojave

Në këtë pjesë, përshkruajmë gjetjet kryesore të vlerësimit të nevojave për këshillim fetar për deradikalizim në Maqedoni nga Horizon CIVITAS. Gjetjet diskutojnë - dhe organizohen rreth - titujve të mëposhtëm: (1) Qasjet e përgjithshme në këshillimin fetar; (2) Zbatueshmëria ose korniza institucionale dhe (3) Përmbajtja dhe zbatimi. Këta tituj përputhen me pyetjet kryesore kërkimore të vlerësimit. Rekomandimet rrjedhin nga prioritetet e palëve të interesuara siç përshkruhen në Seksionin 5.

Gjetjet tona nuk i përgjigjen çdo pyetjeje të bërë gjatë mbledhjes së të dhënave. Në vend të kësaj, ato theksojnë:

- Probleme që përsëriten: Pyetje që shpesh herë përmenden nga të anketuarit edhe në dokumente.

- Diskutime të zgjatura: Tema që morën më së shumti vëmendje gjatë mbledhjes së të dhënave.

- Tema të vëzhguara gjerësisht: Probleme të përmendura nga grupe të ndryshme të intervistuara.

Kemi përdorur pika dhe font më të trashë për të theksuar gjetjet kryesore. Numri dhe detajet e gjetjeve ndryshojnë në varësi të temës, si reflektim i thellësisë së informacionit të mbledhur.

Qasjet e përgjithshme ndaj këshillimit fetar

Ky seksion përshkruan idetë fillestare, të kuptuarit dhe qasjet ndaj këshillimit fetar në Maqedoni. Meqenëse grupi i pyetjeve në këtë seksion përbëhej nga pyetje më të personalizuara, reagimet nga palët e interesuara pritej të ishin më shumë opinione personale subjektive, sesa inpute objektive të racionalizuara. Për më tepër, përgjigjet ishin të përgjithshme. Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se çështjet në këtë fazë fillestare kishin të bënin me popullatën e përgjithshme të burgjeve dhe jo vetëm me VEP.

Një gjetje e rëndësishme në fillim të diskutimit është se informacionet kthyese nga intervista me informuesin sugjerojnë një qëndrim të përgjithshëm pozitiv ndaj këshillimit fetar. Ajo çka mbetet një detyrë komplekse është vërtetimi nëse kjo preferencë e favorshme për këshillim fetar rrjedh nga religjioziteti i subjektit ose nga një orientim më i gjerë konstruktiv ndaj riintegrimit, rehabilitimit dhe risocializimit të të burgosurit. Vlen të përmendet se vetëm një numër i kufizuar i të anketuarve kanë bërë vërejtje teorike në lidhje me përdorimin e

këshillimit fetar si masë parandaluese ose kundërveprim ndaj ekstremizmit gjatë burgosjes së tyre ose pas lirimit të tyre. Kjo çon në përfundimin se këshillimi fetar më së shpeshti shihet si një koncept teologjik.

Bazuar në të dhënat e disponueshme dhe intervistat me informatorët, këshillimi fetar mund të jetë relativisht i dobishëm për të dënuarit në Maqedoni. Disa të anketuar kanë theksuar potencialin e keqpërdorimit të një programi të tillë për shkak të qëllimeve misionare fetare të këshilltarëve të caktuar në zbatimin e këtij programi. Propozimi i paraqitur thekson se dobia e programit qëndron në natyrën e tij të mirëpërcaktuar, të strukturuar, të monitoruar nga afër nga institucionet përkatëse dhe të kryer nga profesionistë të pajisur me ekspertizën e nevojshme.

Kur u pyetën për metodën më efektive të kryerjes së këshillimit fetar në Maqedoni, pothuajse të gjithë të anketuarit deklaruan se kjo masë duhet të jetë në baza vullnetare me kërkesë të të dënuarve, dhe jo si një program i detyrueshëm rehabilitimi. Palët e interesuara nga institucionet fetare e justifikuan këtë qasje, duke përmendur bazën fetare, me argumentimin se nga pikëpamja fetare, individët nuk mund të detyrohen që t'u përmbahen besimeve dhe vlerave fetare.

Të dhënat sugjerojnë se ekziston një besim i përgjithshëm se këshillimi fetar do të pritej mirë nga popullata e burgut. Kur u pyetën për të vërtetuar këtë gjë, përgjigjet e tyre treguan se këshilltarët posedojnë kapacitetet e nevojshme për të nxitur ndjenjën e pendimit midis të burgosurve për krimet e tyre. Për më tepër, ata konsiderohen të aftë të nxisin të menduarit konstruktiv për të ardhmen, duke kontribuar kështu në qëllimet gjithëpërfshirëse të këtij koncepti brenda burgut.

Zbatueshmëria ose korniza institucionale

Në këtë seksion prezantohet dhe elaborohet korniza më efikase institucionale në Maqedoni për zbatueshmërinë e këshillimit fetar gjatë kohës së qëndrimit në burg dhe pas lirimit. Rishikimet e disa dokumenteve, si dhe pyetjet e këtij seksioni, synuan të njihnin standardet, operacionet, procedurat dhe/ose metodat më të zbatueshme për kryerjen e këshillimit fetar në vend. Kështu, zbulohen kapacitetet aktuale institucionele, sfidat dhe nevojat për zbatimin e këshillimit fetar në praktikë. Në këtë drejtim, studimi në këtë seksion përqendrohet në shqyrtimin e burimeve njerëzore, operacionale dhe financiare të institucioneve përkatëse dhe palëve të interesuara.

Pikëpamja mbizotëruese midis shumicës së palëve të interesuara dhe përfaqësuesve institucionalë në vend është se Komisioni për Marrëdhëniet me Bashkësitë Fetare dhe Grupet Religjioze në Maqedoni (KMBFGR) duhet të jetë organi i caktuar përgjegjës për koordinimin dhe zbatimin e këshillimit fetar si në periudhën e burgut ashtu edhe pas saj.

Disa të anketuar e justifikuan qëndrimin e tyre duke theksuar se KMBFGR është institucioni më i përshtatshëm për këtë masë, për shkak të: së pari, fokusit të institucionit në çështjet që lidhen me peizazhin fetar në vend dhe së dyti, rolit të tij në koordinimin e institucioneve publike me komunitetet fetare, të cilat nuk konsiderohen institucione publike. Nga ana tjetër, disa argumentuan se KMBFGR është një organ i pavarur në administratën shtetërore dhe për këtë arsye, nuk mund të kryejë në mënyrë efektive detyra të tilla të gjera operacionale si koordinimi i burimeve të rëndësishme njerëzore, operacionale dhe financiare.

Në këtë drejtim, qasja e shumicës është se KMBFGR si institucioni përgjegjës për këtë masë, mund të krijojë një Grup Punues për Këshillimin Fetar të përbërë nga: (1) institucionet shtetërore, përfshirë Drejtorinë për Ekzekutimin e Sanksioneve, Komitetin Kombëtar për LEDH dhe LT; (2) institucionet akademike shtetërore, siç është Fakulteti Filozofik i Universitetit Shën Kirili dhe Metodi, Fakulteti i Teologjisë Ortodokse të Krishterë, Fakulteti i Shkencave Islame dhe organizatat e besueshme të shoqërisë civile që punojnë në këtë fushë, dhe (3) komunitetet fetare të njohura me kushtetutë, përfshirë Kishën Ortodokse Maqedonase – Kryepeshkopata e Ohrit (KMO-AO) dhe Bashkësinë Fetare Islame (BFI). Disa thonë se institucionet akademike fetare dhe komunitetet fetare nuk mund të marrin pjesë drejtpërdrejt në një grup pune të iniciuar nga shteti për shkak të karakterit laik të shtetit. Në vend të kësaj, propozimi është që KMBFGR të krijojë një Mekanizëm për konsultime me ta dhe t›ia përcjellë pikëpamjet e tyre Grupit të punës për këshillim fetar të përbërë nga institucione shtetërore.

Një problem tjetër në këtë seksion ishin debatet për përfshirjen e institucioneve të sigurisë në Grupin e mundshëm të punës për këshillim fetar. Edhe pse shumica e të anketuarve institucionalë theksuan domosdoshmërinë e përfshirjes së institucioneve të sigurisë për të kryer kontrolle të sigurisë për punëtorët fetarë që marrin pjesë në këtë masë, të anketuarit e lidhur kryesisht me komunitetin akademik argumentuan se një përfshirje e tillë çon në sigurimin e pajustifikuar të masës dhe se kjo qasje mund të ketë efekte negative mbi palët e interesuara që lidhen me praktikat fetare.

Të pyetur se cila është metoda më e përshtatshme e rekrutimit të punëtorëve fetarë për këshillim fetar, është vërtetuar se te shumica e palëve të interesuara mbizotëron pikëpamja se qasja optimale për Maqedoninë është që komunitetet fetare të paraqesin një listë të propozuar të punëtorëve fetarë deri te KMBFGR. Më pas, KMBFGR mund të lidhë kontrata individuale të përkohshme shërbimi me punëtorët e emëruar. Një numër i madh i aktorëve institucionalë thanë se kuadri ligjor ekzistues në vend mundëson këtë proces të “outsourcing” të shërbimeve, kështu që nuk do të ketë nevojë të krijohet një kuadër shtesë për angazhim.

Pas procesit të angazhimit, shumica e të anketuarve kishin mendimin se metoda më e përshtatshme e raportimit midis institucioneve kompetente, përkatësisht KMBFGR dhe

ofruesve të shërbimeve, veçanërisht punonjësve fetarë të përfshirë në këshillimin fetar, ishte përmes takimeve të rregullta mujore koordinative. Kjo mund shërbejë si një mënyrë më praktike për sigurim të informacioneve kthyese dhe vlerësim të duhur të efektivitetit të masës.

Kur bëhet fjalë për kapacitetet aktuale për sa i përket burimeve njerëzore, qasja e shumicës është se vendi ka një numër të mjaftueshëm njerëzish për të zbatuar një masë të tillë. Palët e interesuara janë të mendimit se institucionet mund të caktojnë individë me ekspertizën e duhur për të qenë pjesë e Grupit të punës dhe se komunitetet fetare kanë një numër të mjaftueshëm të punëtorëve fetarë, të cilët mund të propozohen për këshillim, si në periudhën e burgut, ashtu edhe pas burgut. Megjithatë, aktorët institucionalë theksuan domosdoshmërinë e përditësimit të kuadrit ligjor që rregullon pjesëmarrjen e zyrtarëve publikë, duke e bërë të qartë përfshirjen e tyre në përshkrimin e punës, detyrave dhe përgjegjësive të tyre. Veç kësaj, nevojitet promovimi i njohurive dhe kualifikimeve profesionale të punonjësve fetarë për këshillim fetar si një parakusht kyç për përfshirjen e tyre.
Sa u përket burimeve operacionale, vlerësohet se nuk ka kapacitete të mjaftueshme për zbatimin e këshillimit fetar, sidomos në burgje. Shumica e të anketuarve kanë thënë se burgjet në shtet nuk kanë kapacitet të mjaftueshëm për të zbatuar këto lloj masash, gjegjësisht kanë mungesë të hapësirave për këshillim individual, pajisjeve (siç është projektori, nëse këshilltari fetar dëshiron të përdorë prezantime me video gjatë këshillimit), dhe mjeteve të transportit (për këshilltarin fetar, nga dhe për në burg). Sa u përket mjeteve financiare, të gjithë janë dakord se institucionet nuk kanë burime të mjaftueshme financiare për të mbuluar zbatimin e një mase të tillë. Gjegjësisht, është çështje diskutimi se deri në çfarë mase qeveria mund të ndajë një buxhet të mjaftueshëm për KMBFGR që të mbulojë shpenzimet për ofruesit e shërbimeve të përkohshme (punëtorët fetarë). Shumica e të anketuarve mendojnë se zbatimi i një mase të tillë me ndonjë implikim financiar mund të jetë e mundur vetëm nëse bashkësitë fetare marrin përgjegjësinë për mbulimin e këtij shërbimi në kuadër të detyrave dhe përgjegjësive ekzistuese të prijësve fetarë.

Gjegjësisht, komunitetet fetare mund të caktojnë persona fetarë, të tillë si priftërinj ose imamë, për të shërbyer në burgje si pjesë e detyrave të tyre të zakonshme brenda komunitetit. Në një skenar të tillë, të dënuarit do të njiheshin si pjesë integrale e komunitetit. Shumë të anketuar gjithashtu sugjeruan që aktivitetet profesionale për ngritjen e kapaciteteve, të tilla si trajnime, vizita studimore, takime të planeve të veprimit, të mbulohen financiarisht përme projekteve të OSHC-ve. Duke qenë se ofruesit e shërbimeve nuk janë nëpunës publikë, disa argumentuan se shërbimet mund të mbulohen në kuadër të projekteve.

Përmbajtja dhe zbatimi:

Në këtë seksion shtjellohet metodologjia e kryerjes së këshillimit fetar në burg dhe pas lirimit. Gjegjësisht, këtu ofrohen qasje ndaj aspekteve të ndryshme që lidhen me këtë masë,

duke përfshirë temat që duhen trajtuar gjatë seancave këshillimore, metodat, formatet dhe format e këshillimit, si dhe shpeshtësinë dhe kohëzgjatjen e seancave. Kështu, ky seksion ofron një përmbledhje solide të mënyrës së kryerjes së këshillimit fetar në Maqedoni. Për të siguruar të dhëna më specifike në lidhje me deradikalizimin, ky seksion përfshin një fokus specifik në masat e këshillimit fetar për VEP ose personat e dënuar për krime që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm dhe pjesëmarrjen në luftërat e huaja në Siri dhe Irak.

Të anketuarit identifikuan tema të shumta që mund të adresoheshin me të dënuarit. Temat që përmenden më shpesh përfshijnë të paturit e një qëllimi në jetë, eksplorimin e drejtësisë dhe padrejtësisë nga një perspektivë fetare dhe nxitjen e empatisë. Kujdesi shëndetësor mendor dhe fizik, prosperiteti ekonomik dhe arritja e statusit pozitiv në shoqëri u përmendën vetëm një herë. Kjo sugjeron që të anketuarit në përgjithësi janë të prirur të riorientojnë botëkuptimin themelor individual të vlerave tek të burgosurit, duke i dhënë përparësi kësaj në vend që të iniciojnë ndryshime përmes nevojave praktike të përditshme.

Megjithatë, kur u pyetën për formatin e këshillimit, mbizotëroi propozimi nga shumica që të përfshihen në biseda tematike bazuar në interesat e të dënuarve, dhe jo në biseda me temat të paracaktuara nga ndonjë prej organeve koordinuese, siç është Grupi i punës për këshillimin fetar dhe ofruesit e shërbimeve (punonjësit fetarë). Vlen të theksohet gjithashtu se anketuesit që preferojnë tema të caktuara paraprakisht kryesisht vinin nga institucionet.

Një çështje tjetër e diskutimit ishte forma e këshillimit fetar. Opsionet që iu dhanë të anketuarve ishin: këshillim individual, takime në grup (me 4-5 të burgosur), predikim për të gjithë të burgosurit (si liturgjia, etj), ose të gjitha këto të kombinuara. Një gjetje interesante është se pothuajse të gjitha palët e interesuara kanë preferuar opsionin e një qasjeje të kombinuar. Gjithashtu, vlen të theksohet se palët e interesuara që i zgjodhën këshillimet individuale ishin zyrtarë të Drejtorisë për Ekzekutimit të Sanksioneve.

Të pyetur për shpeshtësinë e këshillimit, shumica e palëve të interesuara treguan se më ideale do të ishte ta kryenin atë një herë në javë. Shumica e të anketuarve konsideronin se një seancë këshillimi fetar duhet të zgjasë maksimumi 1 orë. Sipas disave, ky kombinim do të ndihmojë në krijimin e një marrëdhënie afatgjatë midis këshilltarit dhe të dënuarit, bazuar në mirëkuptimin dhe respektin reciprok. Një i anketuar tjetër tha se një herë në javë është ideale, por mund të jetë e vështirë për institucionet të kryejnë detyrat që kjo masë nënkupton brenda një kornizë të tillë kohore.

Një gjetje tjetër e rëndësishme është se të gjitha subjektet ranë dakord që dhënia e fletushkave ose librave të burgosurit nga këshilltari fetar duhet të përdoret si një mjet shtesë këshillimi. Shumë prej tyre ishin të mendimit se inkurajimi i leximit mund të nxisë një ndjenjë ndryhsimi të brendshëm më të madh në jetën e një personi të dënuar. Përveç kësaj, mund të ndihmojë në krijimin e një lidhjeje më të madhe emocionale midis të burgosurit dhe këshilltarit, gjë që mund të kontribuojë që këshilltari të pozicionohet si një udhëzues pozitiv në jetën e tyre.

Këshillim për deradikalizim

Ky seksion eksploron se si këshillimi fetar mund të ndihmojë ata që janë kthyer nga luftimet në Siri dhe Irak, veçanërisht gratë dhe fëmijët e rekrutuar nga grupet terroriste duke përdorur arsye fetare të shtrembëruara. Qëllimi kryesor i grupit të çështjeve të mbuluara në këtë seksion ishte hartëzimi i sfidave, nevojave dhe kapaciteteve specifike në lidhje me këshillimin fetar si një masë për të deradikalizuar këtë grup specifik të synuar. Për më tepër, ky seksion ka ndihmuar për të parë të gjitha dallimet midis qasjeve ndaj metodologjisë së kryerjes së këshillimit fetar, midis popullsisë së përgjithshme të burgjeve dhe VEP, individë të dënuar për krime që lidhen me pjesëmarrjen në luftërat e huaja në Siri dhe Irak.

Kur u pyetën nëse masa e këshillimit fetar për të kthyerit duhet të jetë e detyrueshme apo jo, palët e interesuara dhanë mendime shumë të ndryshme. Shumica thanë se nxitësi themelor i radikalizimit dhe veprimeve të tyre të dhunshme rrjedh nga keqinterpretimi i fesë ose miratimi i interpretimeve ideologjike që justifikojnë dhunën psikologjike dhe fizike, duke e bërë të domosdoshëm këshillimin e detyrueshëm që përqendrohet në riorientimin fetar. Përveç kësaj, disa kanë deklaruar se çdo përpjekje për deradikalizim që nuk përfshin punëtorët fetarë si udhëheqës të procesit është e destinuar të dështojë. Në të kundërt, ka nga ata që argumentojnë se imponimi i këshillimit të detyrueshëm fetar ndaj këtij grupi të veçantë mund të çojë në pasoja negative. Në vend të kësaj, ata propozojnë që t›u lejohet individëve të shprehin vullnetarisht gatishmërinë e tyre për t'u përfshirë në diskutime për çështje fetare me këshilltarët fetarë. Në një situatë ideale, sipas disave, punëtorët fetarë që marrin pjesë në çfarëdo program deradikalizimi, (të detyrueshëm ose me zgjedhje), duhet të kenë një kuptim të gjerë të mësimdhënies vehabiste. Kjo është diçka kritike sepse të kthyerit nga lufta shpesh mbështeten tek ata në interpretimet dhe praktikat e tyre të përditshme fetare. Prandaj, disa kanë sugjeruar se këshilltarët më të përshtatshëm për riorientimin fetar të këtij grupi specifik janë imamët që u përkasin mësimeve të moderuara vehabiste. Besohet se ata janë më së miri të pajisur për t'u marrë në mënyrë efektive me keqinterpretimet që mbizotërojnë në këtë grup të synuar.

Në cilindo skenar të zbatimit, ekziston një besim njëzëri se këshillimi fetar të mund të ketë një ndikim shumë pozitiv te ish-luftëtarët e kthyer, përfshirë këtu gratë dhe fëmijët. Me fjalë të tjera, palët e interesuara po i afrohen pozitivisht krijimit të një mekanizmi të këshillimit fetar të përshtatur për këtë grup të synuar. Megjithatë, disa sugjerojnë se vullneti politik i institucioneve publike dhe Bashkësisë Fetare Islame për të ndërmarrë hapa konkretë në krijimin e një mase të tillë të deradikalizimit mbetet një sfidë kryesore ose temë diskutimi.

Kur u pyetën posaçërisht për tema në lidhje me të kthyerit, përfshirë gratë, përgjigjet kryesisht u kthyen në diskutime të drejtpërdrejta të përqendruara në çështje të njohura që lidhen me radikalizimin islamik dhe ekstremizmin e dhunshëm. Temat më të shpeshta të përmendura ishin (1) interpretimi i xhihad-it(që do të thotë "përpjekje" ose "luftë" në

arabisht) (2) integrimi shoqëror me njerëz me prejardhje të ndryshme fetare në vendet ku nuk sundon sheriati (ligjet islame) (3) zgjidhja jo e dhunshme e konflikteve (4) respektimi i lirisë fetare si një vlerë thelbësore në Islam dhe (5) të drejtat e grave në Islam. Kjo listë e temave tregon një ndryshim drastik në qasjet e të anketuarve në lidhje me temat e këshillimit fetar që duhet t'i transmetohen popullatës së përgjithshme të burgjeve, gjegjësisht personave VEP.

Një tjetër ndryshim pikëpamjesh kishte të bënte me formatin e këshillimit. Ndërsa shumica e të anketuarve priren të besojnë se këshillimi i kombinuar (individualisht, në grupe, predikim) është më ideali për popullatën e përgjithshme të burgjeve. Nga ana tjetër, pothuajse të gjithë deklaruan se çdo këshillim me VEP duhet të kryhet vetëm individualisht. Kjo qasje ndaj këshillimit fetar të personave VEP u mbështet kryesisht nga supozimi se këshillimi fetar në grup me VEP mund të përfundojë vetëm si debat i panevojshëm, në vend që të jetë një këshillim kontekstual përmes shkëmbimit të ideve.

Një ndryshim tjetër në qëndrimet midis popullatës së përgjithshme të burgjeve dhe personave VEP është shpeshtësia këshillimit. Një numër i madh i të anketuarve besojnë se këshillimi fetar për VEP duhet të jetë më i shpeshtë. Kjo u deklarua në përgjigje të pyetjes se sa shpesh personat VEP duhet të kenë këshillim fetar. Ndërsa për popullatën e përgjithshme të burgjeve shumica tha një herë në javë, për VEP shumica thanë së paku dy herë në javë.

Përveç kësaj, ekziston një dakordësi midis të gjithë aktorëve që çdo këshillim fetar si pjesë e programeve të de-radikalizimit për VEP duhet të jetë gjithashtu pjesë e masave post-ndëshkuese. Gjegjësisht, të gjithë u pajtuan se përfshirja e këshillimit fetar në shërbimet e probacionit është diçka thelbësore, që do të kontribuojë më tej në një riorientim pozitiv fetar në periudhën pas lirimit.

Kur u pyetën për formatin e këshillimit fetar me të kthyerit, përfshirë gratë dhe fëmijët, deri në periudhën pas burgut, të anketuarit anuan nga kombinimi i formave të ndryshme: vizita familjare në shtëpi, takime individuale në xhami, si dhe vende joformale si kafene dhe restorante, në vend që të favorizonin ndonjë qasje të veçantë.

Praktika të mira

Shumë vende në mbarë botën e shohin këshillimin fetar si një mjet efektiv në përpjekjet e deradikalizimit brenda dhe jashtë burgjeve. Deradikalizimi në burgje dhe më vonë, megjithëse një çështje komplekse dhe e ndjeshme, mund të përfitojë nga përfshirja e këshillimit fetar kur ai zbatohet me kujdes dhe përgjegjësi. Në vijim do të gjeni disa përshkrime të praktikave të mira të këshillimit fetar gjatë periudhës në burg dhe pas saj nga vende të ndryshme, të përshkruara me temë dhe mekanizëm të funksionimit:

1. Këshillimi fetar në partneritet me shoqërinë civile dhe institucionet teologjike:
   - Shqipëri: Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm e Qeverisë së Shqipërisë i kërkoi Universitetit Beder - Departamenti i Studimeve Islame, si dhe Komunitetit mysliman të Shqipërisë që të sigurojnë teologë dhe imamë (gra dhe burra) me njohuri për Islamin dhe psikologjinë. Ata kanë këshillim të rregullt fetar me gra dhe fëmijë të kthyer nga konfliktet e huaja në Siri dhe Irak. Për më tepër, Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza në partneritet me Këshillin ndërfetar të Shqipërisë kohët e fundit ka nisur një projekt të ri për ngritjen e kapaciteteve të punëtorëve fetarë shtesë për të kryer këshillime fetare në burgje.

2. Dialogu dhe mirëkuptimi ndërfetar:
   - Indonezia: Programi “Ndërtojmë ura” në Indonezi bashkon të burgosur të besimeve të feve dhe prejardhjeve të ndryshme, dhe lehtësohet nga këshilltarë fetarë të trajnuar. Kjo nxit mirëkuptimin dhe respektin reciprok, përkundër ideologjive ekstremiste.

3. Riformulimi narrativ dhe transformimi i identitetit:
   - Arabia Saudite: “Programi për udhëzim dhe rehabilitim” i Arabisë Saudite punon me studiues dhe këshilltarë fetarë për t’i ndihmuar të burgosurit të riformulojnë narrativat e tyre dhe të zhvillojnë një identitet pozitiv duke tejkaluar ideologjitë ekstremiste. Kjo mund të përfshijë riinterpretimin e teksteve fetare dhe eksplorimin e rrugëve alternative sa u përket vlerave të tyre.

4. Riintegrimi dhe mbështetja e komunitetit:
   - Maroko: “Programi për parandalimin e recidivizmit Dar Talib” në Maroko ofron këshillim fetar bashkë me trajnimin profesional dhe mbështetjen e të burgosurve të liruar. Kjo qasje holistike inkurajon riintegrimin dhe zvogëlon rrezikun e radikalizimit të sërishëm pas lirimit.

5. Qasje të ndjeshme kulturalisht dhe të informuara për traumat:
   - Kanada: Programi i Kanadasë "Rimëkëmbja shpirtërore indigjene në burgje" njeh lidhjen midis traumës historike dhe ekstremizmit te komunitetet indigjene. Programi ofron këshillim fetar të ndjeshëm kulturor që përfshin praktikat tradicionale për shërimin dhe trajtimin e traumave bazore.

6. Të theksuarit e mendimit kritik dhe arsimit fetar:
   - Gjermani: "Rrjeti për parandalimin e dhunës në Gjermani" trajnon priftërinjtë e burgjeve për t'u përfshirë në diskutime kritike me të burgosurit rreth teksteve dhe ideologjive fetare. Kjo i përgatit ata që të mund të kundërshtojnë interpretimet ekstremiste dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre të të menduarit kritik.

Këto praktika të mira ofrojnë njohuri të vlefshme për përdorimin e përgjegjshëm të këshillimit fetar në përpjekjet për deradikalizim në burgje. Rehabilitimi i suksesshëm kërkon një qasje të shumëanshme që u jep përparësi nevojave individuale, respekton diversitetin fetar dhe nxit të menduarit kritik duke respektuar rrethanat etike dhe të sigurisë.

Përfundime dhe rekomandime

Pjesa përfundimtare e këtij raporti përmbledh gjetjet kryesore, sfidat, rekomandimet dhe praktikat e mira të identifikuara në raport. Ai gjithashtu thekson fushat e mundshme për analiza të mëtejshme dhe thekson rëndësinë e adresimit të mungesës së përfshirjes së komuniteteve fetare në masat e për P/LEDH dhe RRR.

Raporti ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse të potencialeve dhe sfidave të përdorimit të këshillimit fetar për deradikalizimin në Maqedoni. Duke adresuar nevojat dhe problemet e identifikuara dhe duke përfshirë praktikat më të mira nga vendet e tjera, Maqedonia mund të zhvillojë një program që promovon riintegrimin, riinterpretimin fetar e që si rrjedhojë parandalon ekstremizmin e dhunshëm.

Këshillimi fetar, nëse kryhet me kujdes dhe me përgjegjësi, ka potencialin për të qenë një mjet i vlefshëm për përpjekjet e deradikalizimit në vend. Diçka thelbësore është adresimi i çështjeve etike dhe të sigurisë dhe miratimi i një qasjeje të shumanshme që të lejojë që kjo masë të funksionojë në mënyrë profesionale. Duke mësuar nga praktikat e mira të vendeve të tjera dhe duke e përshtatur me kujdes programin për kontekstin specifik, Maqedonia mund të maksimizojë potencialin e këshillimit fetar për rehabilitim dhe deradikalizim efektiv. Duke marrë parasysh situatën aktuale, Maqedonia konsiderohet si një vend që ofron një bazë ligjore për respektimin e lirisë së fesë, besimit dhe praktikave të individëve. Duke iu referuar Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve të Maqedonisë, neni 194 - E drejta për përmbushjen e nevojave fetare, e cila rregullon të drejtën e të burgosurve për të përmbushur ndjenjat dhe nevojat e tyre fetare; Maqedonia mund të zhvillojë një masë të këshillimit fetar që do të ndihmojë popullatën e burgut jo vetëm të gëzojë të drejtat sipas këtij neni, por edhe të lehtësojë riintegrimin dhe rehabilitimin e tyre – si shtylla themelore të kohës së kaluar në burg.

Raporti sugjeron gjithashtu se adresimi i tendencës së (ri)radikalizimit në burgje është vendimtar. Mungesa e bashkëpunimit midis Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve dhe Bashkësisë Fetare Islame, veçanërisht në fushën e ritualeve të rregullta të lutjes, siç është lutja e së premtes, përfshirë predikimin fetar - një ritual që VEP e përdor me sukses për të radikalizuar të dënuarit e tjerë, krijon një hendek në përpjekjet për të parandaluar radikalizimin në burgje.

Në Maqedoni, ekziston një qëndrim pozitiv ndaj zbatueshmërisë së masave të këshillimit fetar. Megjithatë, motivimi themelor pas kësaj mbështetjeje mbetet i paqartë, (prirja fetare apo rehabilitimi). Për popullatën e përgjithshme të burgjeve, favorizohet këshillimi vullnetar. VEP (personat e dënuar për ekstremizëm të dhunshëm dhe luftëra të huaja) kanë mendime të ndryshme sa i përket natyrës së detyrueshme të programeve.

Komisioni për Marrëdhënie me Bashkësitë Fetare dhe Grupet Religjioze (KMBFGR) konsiderohet institucioni më i përshtatshëm për të koordinuar dhe zbatuar këshillimin fetar, me potencialin për të krijuar një grup pune me palë të ndryshme të interesuara. Temat mbi të cilat bëhet këshillimi përsëriten, si qëllimi në jetë, drejtësia, empatia dhe riinterpretimi fetar. Këshillimi i kombinuar individual dhe në grup preferohet për popullatën e përgjithshme, ndërsa seancat individuale për VEP. U sugjerua që këshillimi duhet të jetë një herë në javë për popullatën e përgjithshme dhe të paktën dy herë për VEP. Vizitat familjare, takimet individuale në xhami dhe mjediset joformale preferohen për riintegrimin e VEP pas burgut. Përballja me keqinterpretimin e teksteve fetare, integrimi shoqëror, zgjidhja jo e dhunshme e konflikteve dhe respektimi i lirisë fetare konsiderohen si çështje vendimtare për VEP. Preferohen këshillime individuale dhe seanca më të shpeshta.

Disa nga sfidat e identifikuara janë si më poshtë:

- Përcaktimi i qëllimeve dhe treguesve të suksesit: Nevojiten qëllime dhe tregues të qartë të suksesit për të vlerësuar efektivitetin e këshillimit fetar në përpjekjet e deradikalizimit.
- Trajnimi i punonjësve fetarë: Programet për trajnimin e punëtorëve fetarë në deradikalizim dhe aftësi të të menduarit kritik janë thelbësore.
- Monitorimi dhe vlerësimi: Duhet vendosur mekanizma monitorimi dhe vlerësimi për të vlerësuar efektivitetin e programit dhe për të bërë rregullime sipas nevojës.
- Konsideratat etike: Është thelbësore që të analizohen me kujdes aspektet etike dhe të sigurisë për të parandaluar abuzimin e këshillimit fetar.

Përveç kësaj, raporti ngre pyetje të rëndësishme në lidhje me përfshirjen e institucioneve të sigurisë në këshillimin fetar dhe shqetësimet lidhur me laicizmin potencial. Këto çështje meritojnë rishikim dhe diskutim të mëtejshëm.

Sfida të tjera të rëndësishme në lidhje me zbatueshmërinë e kësaj mase janë mungesa e kapaciteteve operacionale dhe financiare. Burimet financiare dhe fizibiliteti operacional i zbatimit të këshillimit fetar duhen vlerësuar me kujdes.

Nga ana tjetër, praktikat e mira tregojnë se partneriteti me shoqërinë civile dhe institucionet teologjike është vendimtar për zbatueshmërinë e kësaj mase. Disa nga praktikat e suksesshme përfshijnë përdorimin e dialogut dhe mirëkuptimit ndërfetar, zbatimin e rikornizimit narrativ dhe transformimit të identitetit, sigurimin e riintegrimit dhe mbështetjes së komunitetit, zbatimin e qasjeve të informuara për traumat dhe të ndjeshme kulturalisht dhe një theksim i nxitjes së mendimit kritik dhe shkrim-leximit fetar.

Si përfundim, ky raport ofron rekomandimet e mëposhtme:

Për institucionet:

Rekomandimi 1 - Krijimi i një grupi të punës për këshillim fetar për RRR të VEP: Ky grup pune krijohet në nivel kombëtar, i udhëhequr nga KMBFGR dhe përbëhet nga DES dhe KNPEDHLT. KMBFGR takohet me komunitetet fetare dhe fakultetet teologjike për koordinimin e punëtorëve fetarë dhe e diskuton këtë me grupin e punës.

Rekomandimi 2 - Përcaktimi i burimeve operacionale dhe financiare: Burimet e nevojshme për kryerjen e këshillimit fetar në burg identifikohen sistematikisht dhe bëhen përpjekje për të mobilizuar pajisjet dhe fondet e nevojshme nga institucionet përkatëse qeveritare ose duke siguruar mbështetje nga organizatat donatore ndërkombëtare.

Rekomandimi 3 - Vendosje e Procedurës Standarde të Operimit (PSO): Në konsultim me BFI-në dhe organizatat përkatëse të shoqërisë civile që punojnë në këto fusha, GP për këshillimin fetar zhvillon PSO për këshillimin fetar në burgje. PSO përcakton të gjitha proceset përkatëse në lidhje me angazhimin, zbatimin, si dhe raportimin për punën e bërë nga punëtorët fetarë.

Rekomandimi 4 - Angazhimi dhe konfirmimi i punëtorëve fetarë të emëruar: Pas kryerjes së një analize të plotë, KMBFGR angazhon punonjës fetarë të kontraktuar individualisht, të cilët posedojnë certifikata të përshtatshme për ofrimin e shërbimeve në kuadër të masave ndëshkuese dhe post-ndëshkuese.

Rekomandimi 5 - Forcimi i kapaciteteve të punonjësve fetarë të angazhuar: Përmirësimi i aftësive dhe motivimit të punonjësve fetarë përgjegjës për kryerjen e këshillimit fetar në burg dhe gjatë periudhës së probacionit pas lirimit përmes trajnimit profesional, vizitave studimore dhe ofrimit të një manuali gjithëpërfshirës. Këto aktivitete gjithashtu mund të zbatohen dhe mbulohen financiarisht nga OSHC-të që punojnë në ato zona.

Rekomandimi 6 – Listë e temave për këshillim fetar: Lista e temave do të përpilohet në bashkëpunim me GP për këshillim fetar dhe komunitetet fetare. Përshtetaje e temave të këshillimit në varësi të grupit të synuar (gra, fëmijë dhe burra).

Rekomandimi 7 - Zbatimi i politikave të monitorimit dhe vlerësimit: Pas zbatimit të Procedurave Standarde të Operimit (PSO) për këshillim fetar, Grupi i punës (GP) për këshillimin fetar zbaton në mënyrë sistematike politikat e monitorimit dhe vlerësimit për të vlerësuar efektivitetin e kësaj mase.

Për Bashkësinë Fetare Islame:

Rekomandimi 1 - Të përpilojë një listë të punëtorëve fetarë të emëruar: BFI-ja përgatit një listë të punonjësve fetarë (sipas qytetit dhe gjinisë për secilin qytet ku ka VEP). Më pas ia dorëzon listën KMBFGR-së për angazhim të mëtejshëm.

Rekomandimi 2 - Të emërojë një person përgjegjës për këshillim fetar: BFI cakton një person/ departament përgjegjës për këshillimin fetar. Mund të jetë sektori i arsimit brenda këtij institucioni. Personi i caktuar është pika e kontaktit për KMBFGR në lidhje me të gjitha proceset që lidhen me këtë masë.

Për shoqërinë civile:

Rekomandimi 1 - Të zbatojnë aktivitete për ngritjen e kapaciteteve për këshillim fetar: Organizatat e shoqërisë civile zhvillojnë projekte që synojnë të ngrenë kapacitetet e punëtorëve fetarë, si dhe të aktorëve të tjerë, në lidhje me zbatimin e këshillimit fetar.

Shtojca

Shtojca A. Identifikimi i palëve të interesuara në vlerësimin e nevojave

Emri i palës së interesuar	
Komiteti Kombëtar për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit	Qëllimi kryesor:
Komisioni për Marrëdhënie me Bashkësitë Fetare dhe Grupet Religjioze në Maqedoni	Qëllimi kryesor:
Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve	Qëllimi kryesor:
Qendra për Punë Sociale	Përkatësia
Bashkësia Fetare Islame	Qëllimi kryesor:
Kisha Ortodokse Maqedonase	Qëllimi kryesor:
Fakulteti i Shkencave Islame	Qëllimi kryesor:
Fakulteti i Teologjisë Ortodokse (të krishterë)	Qëllimi kryesor:
Fakulteti Filologjik	Përkatësia
Fakulteti i Psikologjisë	Përkatësia
Fakulteti i Drejtësisë	Përkatësia
Organizatat lokale të shoqërisë civile	Përkatësia
Organizatat ndërkombëtare të shoqërisë civile	Përkatësia
Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë së Veriut	Përkatësia
Zyra e Këshillit të Evropës të Maqedonisë së Veriut	Financimi:
Analistë të opinionit publik	Përkatësia
Ekspertët e sigurisë	Përkatësia:

Shtojca B. Referencat dhe listë e dokumenteve të shqyrtuara

Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Komiteti Kombëtar për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit

2023 Strategjia Kombëtare për Luftimin e Ekstremizmit të Dhunshëm
2023 Plani i veprimit për zbatimin e strategjisë për luftimin e ekstremizmit të dhunshëm

Komisioni për Marrëdhënie me Komunitetet dhe Grupet Fetare

2007 Ligji pozitën juridike të kishës, bashkësisë fetare dhe grupit religjioz

Ministria e Drejtësisë, Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve

2019 Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve
2019 Ndryshime në ligjin për ekzekutimin e sanksioneve
2019 Ndryshime në ligjin për ekzekutimin e sanksioneve

Komisioni Evropian

2022 Raporti për Maqedoninë e Veriut 2022

Këshilli i Evropës

2016 Manual për shërbimet e burgjeve dhe probacionit në lidhje me radikalizimin dhe ekstremizmin e dhunshëm
2016 Njihni të drejtat tuaja
2019 Zbatimi i sanksioneve dhe masave në komunitet

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) dhe Reforma Ndëshkuese Ndërkombëtare

2022 Mbrojtja e të drejtave të njeriut në burgje, duke parandaluar radikalizimin që çon në terrorizëm ose dhunë

Rrjeti i Ndërgjegjësimit për Radikalizimin (RNR)

2017 Roli i religjionit në programet për dalje dhe këshillimi fetar në burg dhe probacion

Ministria e Shkencës, Teknologjisë dhe Mjedisit Malajzi dhe Qendra për hulumtim dhe menaxhim të inovacioneve, Universiteti Kombëtar i Malajzisë

2012 Ndikimi i udhëheqjes fetare dhe këshillimit te të burgosurit në Malajzi Vetëbesimi

Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogë dhe Krim (UNODC)

2016 Menaxhimi i shkelësve të dhunshëm ekstremistë dhe parandalimi i radikalizimit që çon në dhunë brenda burgjeve

Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP)

2016 Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm përmes promovimit të zhvillimit gjithëpërfshirës, tolerancës dhe respektit për diversitetin

Universiteti George Fox

2019 Roli i fesë në shoqëritë e Ballkanit Perëndimor

Universiteti Shtetëror i Minesotës Moorhead

2023 Praktikat më të mira në këshillimin e popullsisë së Ballkanit: Trajnim për këshilltarët e shëndetit mendor

Shtojca C. Udhëzues për intervistë

Raporti i vlerësimit të nevojave për këshillim fetar për deradikalizim

Udhëzues për intervista

Emri dhe mbiemri i plotë i të anketuarit: _____
Institucioni:_____
Anëtari i ekipit hulumtues: _____ **Data:**_____

Pas prezantimit të pyetësorit, ku shpjegohet dhe qëllimi, rëndësia dhe shtrirja e fushës së interesit, hulumtuesi i bën pyetjet e mëposhtme për t'u siguruar që gjithçka është e qartë:

- A i kuptoni parametrat e bisedës sonë?
- A keni ndonjë pyetje për momentin?

I.Qasja e përgjithshme ndaj këshillimit fetar

1. Deri në çfarë mase jeni informuar për këshillimin fetar në burgje?

2. Deri në çfarë mase mendoni se këshillimi fetar mund të jetë i dobishëm për personat e dënuar?

3. Cila është mënyra më efektive për të zbatuar këshillimin fetar në Maqedoni?

a) Të jetë i detyrueshëm për të gjithë të dënuarit
b) Të jetë me zgjedhje, me kërkesën e të dënuarit
Si do të mirëpritet kjo masë nga të dënuarit në Maqedoni?
a) Do të pritet shumë mirë
b) Nuk do të pritet dhe aq mirë
c) Do të pritet keq

4. a Pse mendoni kështu (a, b ose c)?

II.Zbatueshmëria ose korniza institucionale

5. Sipas mendimit tuaj, cili nga institucionet e mëposhtme duhet të jetë përgjegjës për zbatimin e kësaj mase?
   a) Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve
   b) Qendra për Punë Sociale
   c) Komisioni për Marrëdhënie me Bashkësitë Fetare dhe Grupet Religjioze në Maqedoni

d) Komiteti Kombëtar për Parandalimin
e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit

6. Duke ndjekur definicionin për një institucion përgjegjës, cili duhet të jetë pjesë e grupit (të mundshëm) ndërinstitucional të punës për këshillim fetar që do të hartojë një plan për zbatimin e këshillimit fetar?

7. A duhet të marrin pjesë komunitetet fetare në këtë grup të punës?

a) Po
b) Jo

8. Cila është mënyra më e mirë për të angazhuar punëtorët fetarë për të kryer këshillime fetare?

a) Thirrje e hapur për punonjës/teologë fetarë nga një institucion kompetent dhe angazhim individual me marrëveshje për kryerjen e këtij shërbimi

b) Koordinim me komunitetet fetare (listë e propozuar me emërime nga BFI dhe MOC) dhe marrëveshje individuale e shërbimit midis institucionit përgjegjës dhe punëtorëve fetarë të emëruar

c) Procedurë e tenderit për prokurimin e shërbimeve nga një institucion kompetent për komunitetet fetare

d) Procedurë e tenderit për prokurimin e shërbimeve nga një institucion kompetent për organizata të ndryshme të shoqërisë civile (përfshirë ato fetare)

e) Pranimi i ofertave nga OSHC-të (përfshirë ato fetare) për të ofruar shërbime për institucionin përgjegjës, pa shpenzime/falas.

9. Si duhet të vendoset koordinimi midis institucionit kompetent, ofruesve të shërbimeve dhe institucioneve të tjera?

Takime të rregullta koordinuese (javore/mujore/tremujore)
Njoftim narrativ nga ofruesi i shërbimit drejt institucionit përgjegjës

10. Cilat janë pikat e forta dhe të dobëta për sa i përket burimeve njerëzore për zbatimin e kësaj mase në Maqedoni?

11. Cilat janë pikat e forta dhe të dobëta në aspektin e burimeve operacionale për zbatimin e kësaj mase në Maqedoni?

12. Deri në çfarë mase vlerësoni se ekzistojnë kapacitetet e nevojshme financiare për zbatimin e këshillimit fetar në Maqedoni?

a) Mirë
b) Mjaftueshëm
c) Pamjaftueshëm

III. Përmbajtja dhe zbatimi:

13. Sipas mendimit tuaj, cilat tema duhet të përfshihen në këshillimin fetar?

14. Në çfarë formati duhet të mbulohen temat?

a) Adresim tematik sipas interesit të personave të dënuar
b) Tema të paracaktuara midis institucionit përgjegjës dhe ofruesit të shërbimeve

15. Në çfarë forme duhet të bëhet këshillimi fetar?

a) Takime individuale këshillimi
b) Takime këshillimi në grup (4-5 persona)
c) Predikim para të gjithë të burgosurve (si liturgji, etj.)
d) Të gjitha sëbashku

16. Sa shpesh duhet të bëhet këshillimi fetar?

a) Një herë në ditë
b) Një herë në javë
c) Shumë herë gjatë javës (dy ose më shumë herë)
d) Njëherë në muaj
e) Spontane sipas nevojës

17. Sa duhet të zgjasë këshillimi fetar?

a) Më pak se një orë
b) Një orë
c) Mbi një orë

18. A duhet të përdoren fletushka ose libra si masë gjatë këshillimit fetar?

a) Po
b) Jo

III a. Këshillim për deradikalizim

19. A duhet të jetë i detyrueshëm këshillimi fetar
për të kthyerit VEP nga Siria dhe Iraku

a) Po
b) Jo

19a. Pse mendoni se a) Po ose b) Jo?

20. Në çfarë mase vlerësoni se kjo masë mund të ketë ndikim në këtë kategori?

a) Ndikim shumë pozitiv
b) Ndikim paksa pozitiv
c) As ndikim pozitiv dhe as negativ
d) Ndikim pak negativ
e) Ndikim shumë negativ

21. Cilat tema fetare duhet të mbulohen gjatë këshillimit fetar për të kthyerit VEP?

22. Si duhet të bëhet këshillimi fetar me të kthyerit VEP?

a) Individualisht
b) Në grup

23. Sa shpesh duhet të marrin këshillim fetar të kthyerit VEP?

a) Një herë në ditë
b) Një herë në javë

Disa herë në javë (dy ose më shumë herë)

a) Njëherë në muaj
b) Spontanisht sipas nevojës

24. A duhet të vazhdojë këshillimi
fetar për të kthyerit VEP edhe pas lirimit nga burgu?

a) Po
b) Jo

25. Nëse po, cili format është më efektiv për këshillim fetar jashtë burgut?

a) Vizita familjare në shtëpi
b) Takime individuale në xhami
c) Takime individuale jashtë xhamisë në vende joformale (kafene, restorant etj.)
d) Të gjitha sëbashku

Komente shtesë:

Shtojca D. Prezantimi i diskutimit në tryezë të rrumbullakët